



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:245507
Datë: 02.04.2024
Numri i dokumentit: 05530705

C-IV.-14-2325

Parashtruesi i kërkesës

M B B Kamenice

Pala kundërshtare

NSH “XIQ Karaqeva” e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), gjyqtarja Manushe Karaqi me 29 mars 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- I. Ankesa e parashtruesit hedhet poshtë si e papranueshme.**
- II. Në këtë çështje juridike nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 3 prill 2014, paditësi ka parashtruar ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit me numër GJI045-0292 i datës 5 prill 2014 me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërperje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 900.00 euro.

Paditësi ka theksuar se baza e refuzimit të kërkesës së tij është e kundërligjshme pasi që ndërmarrja ka hyrë ne proces të likuidimit dhe pagat që kanë mbetur borgj mbesin në përgjegjësi

të Punëdhënësit. Kësisoj, ka kërkuar nga gjykata që pas rishikimit të vendimit të atakuar, të njëjtin ta anuloj ashtu që parashtruesit ti njihet e drejta në kompensimin e tri pagave të papaguara, ose të njëjtin ta kthejë në rivendosje Autoritetit të Likuidimit.

Paditësi ka bashkangjitur kopjen e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit me numër GJI045-0292 i datës 5 prill 2014 si dhe Njoftimin për ndërperje të marrëdhënies së punës me datë 15 gusht 2006.

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka nxjerrë vendimin në fjalë duke u bazuar në Nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, i cili parasheh që: "...elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë:....kërkesa apo pretendimi është i parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”.

Kërkesa e parashtruesit u refuzua si e pavlefshme duke ju referuar Nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas Nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, që parashikon që ‘pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet’.

Në bazë të dispozitave të mësipërme, sipas AKP-së kërkesa do të duhej të ishte paraqitur në gjykatë apo ndonjë organ kompetent brenda tri viteve nga momenti kur NSH-ja nuk ka arritur t’i përmbush obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Më 14 dhjetor 2016, AKP-ja dorëzoi mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtruesit kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI045-0292 i datës 5 prill 2014 AKP-ja përmes mbrojtjes së saj kërkon nga Dhoma e Posaçme që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar, dhe të vërtetojë (lë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të GJI045-0292 i datës 5 prill 2014.

Më 6 mars 2024 Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka lëshuar një urdhër me të cilin parashtruesit iu kërkua që brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri të dorëzojë Kopjen e Librezës së punës, Njoftimin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës si dhe Listën e pagave. Në bazë të fletëkthesave që gjinden në shkresat e lëndës, gjykata vëren se parashtruesi e ka pranuar urdhrin e gjykatës me 11 mars 2024, por nuk e ka dorëzuar ende dokumentacionin e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa konsiderohet e papranueshme.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në kuptim të nenit 76.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktvendim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësata apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese).

Pika 3 e këtij neni parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Dhoma e Posaçme, pasi që shqyrtoi ankesën e dorëzuar dhe shkresat e tjera të lëndës konstatoi se ankesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme. Neni 36 paragrafi 2 pika 2.5 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton se *”kërkesa/ ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të këtij ligji”*.

Neni 35 paragrafi 2 pika 2.4 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton se ankesa duhet të përmbajë: *“lëndën dhe të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me kërkesën ose ankesën, bazën për juridiksionin parësor të Dhomës së Posaçme në lidhje me kërkesën apo ankesën, argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet kërkesa apo ankesa dhe një listë provash që parashtruesi synon t'i paraqes”*.

Gjykata vëren se Parashtruesi me ankesë për gjykatën ka prezantuar Vendimin e AL-së GJI045-0292 i datës 5 prill 2014 dhe Njoftimin e ndërperjes së marrëdhënies së punës.

Parashtruesi kërkon nga gjykata që t'i njihet e drejta në kompensimin për tri paga të papaguara në shumën prej 900.00€. Megjithatë parashtruesi lidhur me periudhën për të cilën ka kërkuar kompensimin monetar nuk ka prezantuar për gjykatën të gjitha provat relevante.

Për më tepër edhe në bazë të nenit 31, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës i cili përcakton se: *‘Palët, në parashtrësata e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës’*.

Me nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parashihet që: *‘në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore’*.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në pajtim me nenin 33 paragrafi 1 dhe nenin 36 paragrafi 2 pika 2.3 e Ligjit për Dhomën e Posaçme vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore:

Duke u bazuar në Nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

**GJYQTARJA,
Manushe Karaçi**